



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

EKUILIBER PROJEKT SH.P.K

Prishtinë, Ulpianë,
Rr.Zija Shemsiu D3/H1/NR11
+38344(049)/378-239
+38344(49)/258-876
ekuiliber.p@gmail.com



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Neni 1

Palët nënshkruese të këti memorandumi:

1. Kolegji BIZNESI- Prishtinë, rruga “Motrat Qiriazi” nr 29 të cilën e përfaqëson Dr. Shyqeri Kabashi -Dekan, dhe
2. EKUILIBER PROJEKT SH.P.K –Prishtinë me NRB 810813247

Neni 2

Qëllimi i këti Memorandumi

Ky Memorandum bashkëpunimi ka për qëllim përcaktimin e fushave të bashkëpunimit, kushteve dhe afatet themelore, në bazë të të cilave Kolegji BIZNESI- Prishtinë dhe EKUILIBER PROJEKT SH.P.K –Prishtinë, pajtohen për bashkpunim.

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

1. EKUILIBER PROJEKT SH.P.K –Prishtinë do të ndihmojë dhe mbështesë në vazhdimësi Kolegjin Biznesi, në pranimin e studentëve për realizimin e praktikës, dhe dhënjën e sygjërimeve për nevojat e ekonomis së tregut si pal e interesit nga jashtë, të bazuar në politikat e këtij institucionit.
2. Kolegji Biznesi do të mbështesë në vazhdimësi EKUILIBER PROJEKT SH.P.K – Prishtinë ne aspektin e trajnimeve në fushat: **menaxhimi i emergjencave** (mbrojtjes nga zjarrit duke kontrolluar dhe servisuar aparaturat për shuarjen e zjarrit), **ekonomis** (hartimin e pasqyrave financiare dhe planit të biznesit), **juridike** (hartimi i kontratave dhe rregulloreve) dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit .
3. Kolegji Biznesi do të mbështes EKUILIBER PROJEKT SH.P.K –Prishtinë me stafin e sajë akademik, për ligjërata nga lëmia: emergjencave, ekonomis dhe juridikut-sipas nevojave që paraqet EKUILIBER PROJEKT SH.P.K –Prishtinë

Neni 4

Interpretimi dhe ndryshimi i memorandumit

1. Interpretimi i këtij Memorandumi do të bëhet në pajtim me Ligjet e Kosovës, duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.
2. Afati i këti memorandumi është në kohë të pacaktuar. Ndryshimet dhe plotësimet e këti Memorandumi mund të bëhen vetëm me shkrim dhe të nënshkruara nga të dyja palët.

Neni 5
Kopjet e Memorandumit

Memorandumi është punuar në katër kopje origjinale, nga dy kopje për secilën palë.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.

PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji BIZNESI Prishtinë

Prof Dr Shyqer Kabashi
D e k a n

EKUILIBER PROJEKT SH.P.K

Dr. Mustafë Kadriaj
Pronar

Nënshkruar në Prishtinë, me datë 03/12/2020